V E N D I M
Nr.456, datë 3.7.2003

PËR STRUKTURËN DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", i ndryshuar dhe të pikave 4 e 6 të nenit 2 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe niveli i pagës për punonjësit e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1 – Diplomë e shkollës së lartë është 9 000 (nëntë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 3) të jetë në masën 2 për qind, pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 4) është 0.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës të lidhjes nr.1.

6. Kategorizimi (kolona 1) brenda çdo klase të bëhet në përputhje me lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Punonjësit e tjerë të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët nuk përfshihen në lidhjet nr.1 dhe nr.2 të këtij vendimi, të paguhen sipas lidhjes II-30 "Niveli i pagës për punonjësit e administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë" dhe sipas lidhjes II/M "Paga bazë, sipas klasave për punonjësit e ministrive, të institucioneve të tjera qendrore, të ATSH-së, të prefekturave dhe të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar" të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", i ndryshuar.

8. Niveli i pagës për emërtesën "sekretar i Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë" të jetë në nivelin e pagës së punonjësve të kategorisë III-a, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1

Klasa	Paga mujore Kategoritë	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4	5
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
I	I-a	9000	2%	0	74 000
II	II-a	9000	2%	0	55 000
II	II-b	9000	2%	0	40 000
III	III-a	9000	2%	0	30 000

Lidhja nr.2

Klasifikimi i vendeve të punës

Klasa I: është niveli më i lartë i menaxhimit të një institucioni dhe ka përgjegjësi për hartimin e politikave në një fushë të caktuar dhe për arritjen e rezultateve të përcaktuara në këtë fushë.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

I-a Drejtor drejtorie

Klasa II: Bën të mundur koordinimin e mendimit dhe të opsioneve të reja politike për një fushë të caktuar të specialitetit, zbatimin e politikave në këtë nivel, përgatitjen e propozimeve përfundimtare, të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë. Kjo klasë bën të mundur gjithashtu edhe zgjidhjen e problemeve komplekse, që lidhen me menaxhimin e projekteve të mëdha ose sektorëve/njësive brenda institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

II-a përgjegjës sektori

II-b përgjegjësi i sektorit

Klasa III: Kjo klasë merret me zbatimin e politikave ekzistuese, koordinimin e aktiviteteve të stafit mbështetës, si dhe me formulimin dhe vlerësimin e opsioneve politike mbi një fushë të caktuar, duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës, njohuritë e specialitetit, analizën e informacionit dhe kërkimin.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

III-aspecialist